



Okarina

TINGULLI I BUKUR I LASHTËSISË





Periudha Kolumbiane
rreth viteve 600-1200



Okarina e Arrigo Mignani-t,
në mesin e shekullit të 20

Okarina është një instrument i lashtë muzikor frymorë, që, sipas shkencëtarëve, është mbi 12.000 vjet e vjetër (epoka neolitike). Forma të ndryshme të okarinës janë përdorur nga kultura të ndryshme në të gjithë botën.

Giuseppe Donati nga Budrio (Itali) ka shpikur të ashtuquajturën 'okarinë klasike' në mesin e shekullit të 19-të, e cila kishte një formë të ngjashme me sqepin e një zogju, e zgjeruar në një diapazon prej 10 (dhjetë) vrimash, ndryshe nga origjinalja që kishte 1 (një) vrimë dhe një oktavë e gjysmë.

Fjala "okarinë" me të cilën instrumenti është i njohur sot është përdorur nga muzikantët e Emilia Romagnas (Itali) dhe do të thotë "patë vogël" në italisht.



Andean Altiplano i
Amerikës Jugore



Xun (okarinë vezore),
Dinastia Han (206
P.K-220 E.S) Kinë



**Okarina origjinale
e zbuluar në Runik/Rudnik**

OKARINA E RUNIKUT/RUDNIK

Në afërsi të fshatit Runik/
Rudnik, në komunën e Skën-
derajt/Srbica, arkeologët zb-
uluan një okarinë të veçantë, e cila ngjason
me kokën e një perëndeshe qiellore.

Kjo Okarinë është zbuluar në fshatin Runik/
Rudnik në fillim të vitit 1970. Ky ekzemplar
i punuar nga argjila e pastruar mirë dhe e
pjekur, me një lartësi prej vetëm 8 cm dhe e
vrimuar si në boshtevrima për gishtërinjë, po
ashtu dhe në aksin më të lartë pipëza, kishte
shërbyer si një instrumenti muzikor frymor,
një lloj fyelli neolitik. Instrumenti ishte
pagëzuar me emrin “Okarina e Runikut”.





OKARINA E SHAQIR HOTIT

Me të dëgjuar për instrumentin, Z. Shaqir Hoti, krijues dhe praktikues i instrumenteve tradicionale të punuara nga druri, nga Prizreni, u bë kurioz për të zbuluar tingujt dhe për të luajtur në okarinë. Edhe pse e kishte shansin ta shihte ekzemplar in origjinal të “okarinës së Runikut» në Muzeun Kombëtar, ai kurrë nuk pati mundësi të luajë dhe të dëgjojë tingujt e saj. Por ai mblodhi të gjithë informacionin e nevojshëm mbi strukturën dhe përbërjen e instrumentit.


Këmbëngulja e tij për të përsosur tingujt e saj, e shtyu të krijonte okarina nga materiale



të ndryshme në punëtorinë e tij në Prishtinë/
Pristina. Në vitin 2010, pas shumë përp-
jekjeve, Shaqir Hoti arriti që më në fund të
prodhojë tingujt të cilët kishte ëndërruar,
gjë që u realizua me okarinën prej balte.
Tingulli i okarinës së punuar nga balta ishte
krejt i ndryshëm nga okarinat e punuara me
materiale të tjera.

*“Kur dëgjova ata tinguj për herë të parë,
u kënaqa. Duke hulumtuar ato dy vrima,
aty gjeta edhe melodi. Pastaj bëra edhe tre
tinguj të tjerë.”* Shaqir Hoti

Pas shumë eksperimentesh në punëtorinë e
tij, në vitin 2009 Shaqir Hoti punoi edhe okar-





inën prej arre. Me një gjysmë lëvozhge arre ai nxori një instrument, i cili tashmë bën pjesë në koleksionin e tij të instrumenteve frymore. Okarina origjinale ka dy vrima të cilat prodhojnë tre tinguj. Është e ditur se instrumentet frymore gjithmonë japin një tingull më tepër se sa vrimat e saj. Tingujt e okarinës orkestrale, në krahasim me origjinalen e Shaqir Hotit, nuk janë të njëjtë, sepse “kjo okarinë ka një tingull krejt të veçantë” (cit. Shaqir Hoti).

Shaqir Hoti vazhdon t’ja kalojë pasionin e tij për këtë instrument brezave të rinj. Studio e tij e punës mund të gjendet në Prishtinë/Pristina.





A i gjithashtu vazhdon të luajë në okarinë, si dhe në instrumentet e tjera tradicionale, me grupin e famshëm të muzikantëve, ansamblin “Azem Bejta”, që nga vitet <70, kur mori çmimin e parë (Okarinën e Artë) në festivalin e mirënjohur “Akordet e Kosovës”.



